

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** “Blerje pjesë këmbimi, vaj, filtra, bateri etj”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT : (FPP) 09211000-1,  
09211100-2, 31440000-2, 34330000-9, 42514310-8, 42913300-2, 42913400-3;**

**Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave** është 2,063,040 (dy milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyzet) lekë pa TVSH.

**Shumatorja e cmimeve për njësi është** 809 950 (tetëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin ekritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas percaktimeve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe të veçanta të kualifikimit(Shtojcat).

## 2.2 Kapaciteti Financiar dhe ekonomik

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron mesatare të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit (2022, 2021, 2020), në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 55, pika 4, " Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43 të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Per rregullat e prokurimit publik" , e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencen dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

**2.2.2** Kopjet e certifikuara të bilanceve për vitet 2022, 2021, 2020 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2.2.3** Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 në të gjitha pikat e ushtrimit të aktivitetit, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Keshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Ne rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Për të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Është kërkuar vetëm viti 2022 për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizikë apo juridikë.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si me poshtë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

**2.3.2** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar minimalisht stafin inxhinierik si më poshtë:

- Ing. Mekanik 1 (një)

Per inxhinierin e mesiperm te paraqitet kontrata e punes (e vlefshme) dhe diploma.

Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesit e mesiperm nuk duhet te figurojne te dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete administratori i operatorit ekonomik te paraqesë deklarate perkatese Krahas deklarates detyrimisht te paraqitet dhe vertetim elektronik (e albania) i kontributeve te sigurimeve shoqerore te inxhinereve te kerkuar. Mos paraqitja e ketij informacioni do të konsiderohet si kusht per skualifikim. (Autoriteti Kontraktor do te verifikojë saktësinë e informacionit. Mos dorezimi i informacionit te sakte apo dorezimi te rreme do te konsiderohet kusht per skualifikim dhe/ose filim te hetimit administrativ per perjashtim te O.E. nga procedurat e prokurimit)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/os ekomponentët e tij.

**2.3.3** Operoret ekonomike pjesemarres duhet te kene te punesuar punonjesit si me poshte:

- Teknik Elektroteknik 1 (nje)
- Saldator 1 (nje)
- Shofere 2 (dy).

Per Teknikun dhe Saldatorin të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin. Per shoferet te paraqitet|leja perkatese e drejtimj Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.", i ndryshuar. Diplomat /certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te reme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/os ekomponentët e tij.

Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit e Prokurimit Publik.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje makinerite si me poshte:

***Makineri dhe pajisje***

- Kamioncina me kapacitet mbajtes minimalisht 1 ton 1 copë
- Kamioncine Pick UP 1 copë
- Pirun per levizjen e paletave te materialeve 1 copë

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noteruar.

- a) Per mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkulimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti).
- b) Per paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo kërkesë është vendosur bazuar në objektin e prokurimit, kriter i nevojshëm per realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje certifikatat e meposhtme te cilesise:

Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise), e vlefshme,

Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit OHSAS 18001:2007 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), ose cetifikaten ISO 45001-201 8 ekuivalente, e vlefshme,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo kërkesë Eshtë vendosur bazuar në objektin e prokurimit, kriter nevojshëm për realizimin me sukses te kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet janë hartuar nga specialistët, përkatës të sektorit, të cilet kanë hartuar dhe preventivin përkatës për këtë objekt konform legjislacionit të prokurimit në fuqi dhe garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë.